



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 347/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.06.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 953 prot., datë 28.05.2019 për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “Printim Faturash”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a.

Ankimues: “Adel Security Print” sh.p.k.
Rruga “Muhamet Gjollësja”, Zogu i Zi, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a
Lagjia “3 Heronjtë”, Rr. “Marin Biçikemi” Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.05.2019 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “*Printim Faturash*”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a.

II.2. Në datën 17.05.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në lidhje me modifikimin e dokumentave të tenderit.

II.3. Në datën 21.05.2019 autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit me anë të shkrsesës nr.606 prot., datë 21.05.2019, duke e pranuar pjesërisht atë.

II.4. Në datën 28.05.2019 operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 05.06.2019, me anë të shkresës nr. 9prot., datë 03.06.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “Printim Faturash”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Adel Security Print” sh.p.k. për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “Printim Faturash”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimit e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-21522-05-10-2019, me objekt “Printim Faturash”, me fond limit 3.239.994 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 953 Protokolli;

Datë 28.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha